MESAZH PËR FAMILJET E FËMIJËVE TË VEGJËL ME AUTIZËM

Një mesazh i rëndësishëm për familjet e Masaçusetsit
Me fëmijë nën moshën 9 vjeç
Të diagnostikuar me çrregullime të spektrit autizëm (Autism Spectrum Disorder)
Regjistrimi i hapur 7 tetor 2013 deri 18 tetor

Seksioni i autizmit i Departamentit të Shërbimeve Zhvillimore (DDS) ka një program të përjashtimit për autizmin që siguron ndihmë personale për fëmijët me autizëm të cilët shfaqin sjellje të rënda, probleme sociale dhe të komunikimit nëpërmjet një shërbimi të quajtur **Expanded Habilitation, Education** (shërbime dhe mbështetje intensive në shtëpi, si analizë e aplikuar për sjelljen, modelet e komunikimit Floor Time (përcaktimi i pikave të forta dhe të dobëta të fëmijës) dhe ato të komunikimit). Ky shërbim ofrohet në shtëpinë e fëmijës ose në mjedise të tjera të zakonshme nën mbikëqyrjen e stafit të trajnuar klinik dhe ofrohet për një periudhë tre vjeçare. Ky përjashtim siguron edhe mbështetje të tjera me bazë komunitetin si aktivitete të integrimit dhe pushimit. Në përfundim të periudhës tre vjeçare të shërbimeve intensive në shtëpi, fëmija mund të ndjekë shërbime suplementare të vazhdueshme (pushime, artikuj e shërbime, etj.) që plotësojnë nevojat e fëmijëve dhe ndihmojnë në daljen nga programi i përjashtimit të autizmit - deri sa fëmija bëhet 9 vjeç.

Aktualisht përjashtimi u shërben mbi 300 fëmijëve në një vit kalendarik dhe ndërsa programi i përjashtimit të autizmit pothuajse është plotësuar tashmë, gjithnjë ka fëmijë që largohen nga programi për shkak se mbushin 9 vjeç ose për arsye të tjera. Për këtë arsye, ne duam një grup aplikantësh nga i cili të marrim fëmijët kur hapen vendet për programin. Prandaj Seksioni i Autizmit ofron mundësinë e aplikimit për përjashtimin gjatë një periudhe të hapur për aplikime. Seksioni a Autizmit e pati regjistrimin e fundit të hapur në prill 2012. **Periudha e regjistrimit të hapur vazhdon nga 7 tetori - 18 tetor. Lutemi sigurohuni që t'ia POSTONI aplikimin Seksionit të Autizmit midis periudhës 7 tetor deri 18 tetor. Seksioni nuk do t'i marrë parasysh kërkesat e bëra jashtë kësaj periudhe.**

Programi i autizmit ruan vende rezervë për fëmijët që janë 3 vjeç dhe që dalin nga ndërhyrja e hershme. Kjo do të thotë se Seksioni i Autizmit rezervon 20 vende për të gjithë shtetin për fëmijët që janë 3 vjeç. Këta fëmijë duhet të plotësojnë të gjitha standardet financiare dhe klinike të pranimit që kërkohen për të hyrë në këtë program.

Përjashtmi për Autizmin u shërben fëmijëve deri sa mbushin 9 vjeç, që kanë çrregullimin e spektrit autizëm dhe që përmbushin kriteret e pranimit për programin e përjashtimit. Të gjitha shërbimet e përjashtimit kërkojnë që fëmija të vazhdojë të përmbushë kriteret financiare dhe klinike të pranimit për programin e përjashtimit.
Ky mesazh ju vë në dijeni për kërkesat për pranim në programin e përjashtimit për autizmin:

Pranimi: kërkesat e mëposhtme janë të domosdoshme për pjesëmarrjen në këtë program:

1. Fëmija duhet të ketë një **diagnozë të konfirmuar** të një çrregullimi të spektrit autizëm, që mund të verifikohet nga Departamenti për Shërbimet Zhvillimore.

2. Fëmija të mos ketë mbushur moshën 9 vjeç. Fëmijët nga lindja e deri në 8 vjeç mund të marrin pjesë.

3. Fëmija është banor i Masaçusetsit.

4. Fëmija plotëson nivelin e kujdesit të nevojshëm për shërbimet në një mjedis të kujdesit të ndërmjetëm për personat me paaftësi intelektuale (ICF/ID) sipas vlerësimit të DEPARTAMENTIT TË SHËRBIMEVE ZHVILLIMORE.

5. Familja parapëlqen që fëmija të marrë shërbimet në shtëpi dhe në komunitet.

6. Fëmija duhet të jetë në gjendje të marrë shërbim në komunitet pa u rrezikuar.

7. Fëmija duhet të ketë një përfaqësues ligjor të aftë për të drejtuar shërbimet dhe mbështetjen për Përjashtimin.

8. Fëmija duhet të vlerësohet nga agjencia e MassHealth se ka të drejtën e mbulimit me MassHealth Standard, bazuar në të ardhurat e familjes. Familjet që nuk kanë aplikuar ende për MassHealth, duhet të aplikojnë në kohën që mbushin kërkesën për pjesëmarrjen në programin e përjashtimit. Më poshtë po japim Udhëzimin për të Ardhurat për MassHealth Standard në 150% në Nivelin Federal të Varfërisë. Me qëllim që të merrni pjesë në programin e autizmit, të ardhurat e familjes duhet të jenë nën nivelin e paraqitur në listë*:

Madhësia e familjes	Në muaj	Në vit
2	$1,939	$23,268
3	$2,442	$29,304
4	$2,944	$35,328
5	$3,447	$41,364
6	$3,949	$47,388

*Në rast se fëmija juaj është nën moshë ose ka një gjendje shëndetësore të veçantë si verbim, shurdhëri ose një sëmundje debilituese kronike, standardet janë të ndryshme nga ato të listuara më sipër; lutemi kontaktoni Seksionin e Autizmit për tu sqaruar në raste të tilla.

Si të merrni pjesë në procesin e pranimit:

1. **Merrni një kopje të formularit për kërkesën për programin e autizmit**
   a. Lutemi kontaktoni Qendrën lokale të Mbështetjes për Autizmin (Autism Support Center) (listuar më poshtë) për të kërkuar Formularin e Aplikimit.
   b. Qendrat e Mbështetjes për Autizmin janë të gatshme për t'ju ndihmuar të plotësoni formularin e aplikimit.
   c. Seksioni i Autizmit do të afishojë të gjitha formularët në faqen në internet të DDS:
      - **www.mass.gov/DDS** nën Autism Spectrum Services'

2. **Plotësoni Formularin e Aplikimit të Programit për Autizmin**
   Për të plotësuar këtë formular ju duhet të keni:
   1. **ditëlindjen e fëmijës**
   2. **numrin e punës (social security) të fëmijës**
   3. **numrin ID të MassHealth të fëmijës**

3. **Dorëzoni Formularin e Aplikimit për Pranimin në Programin për Autizmin**
   - Të gjithë formularët duhet të kenë vulën e postës ose të datës midis **(7 tetorit 2013 dhe 18 tetorit 2013)**
   - Seksioni i Autizmit nuk do të marrë parasysh formularët që merren pas kësaj periudhe kohore të caktuar.
   - Lutemi kompletoni formularin me stilolaps dhe shkruani qarrtë me germa shtypi.
   - Lutemi e nënshkruani formularin me stilolaps.
   - VETËM NJË APLIKIM PËR FËMIJË - Seksioni i Autizmit nuk do të pranojë formularët e dërguar disa herë
   - Lutemi dërgojeni me postë formularin (Seksioni i Autizmit nuk i pranon formularët e dorëzuar dorazi) në:
     AUTISM DIVISION of DDS
     Att. Autism Program Application Form
     500 Harrison Avenue, Boston, MA 02118

MESAZH PËR FAMILJET E FËMIJËVE TË VEGJËL ME AUTIZËM

Seksioni i Autizmit i DDS e ka prioritetin e vet që procesi për kërkesën për tu pranuar në programin e përjashtimit të autizmit të jetë i hapur ndaj familjeve dhe fëmijëve me autizëm që vijnë nga tabanë të ndryshme kulturore dhe gjuhësore.

Seksioni i Autizmit i DDS vë në dispozicion formularët e aplikimit për programin e autizmit në shumë gjuhë. Lutemi hyni në faqen e internetit të DDS ose merrni në telefon një nga shtatë Qendrat e Mbështetjes për Autizmin të financuara nga DDS për të kërkuar një kopje në gjuhët spanjisht, haitiane-kreole, kmer, ruse, portugalisht, shqip, vietnameze dhe kineze/mandarin.

Ky njoftim si dhe informacionin tjetër për përjashtimin mund ta gjeni në faqen në internet të DDS në www.mass.gov/DDS nën 'Autism Spectrum Services dhe në Autism Support Centers të financuara nga DDS. Për informacion të mëtejshëm rreth programit të përjashtimit për autizmin, kontaktoni Qendrën lokale të Mbështetjes për Autizmin ose merrni në telefon falas në numrin 1-(888)367-4435.

Listimi i qendrave për përkrahje të autizmit:

ACL: Community Resources for People with Autism (CRPA)
(Burime të komunës për njerëz me autizëm)
116 Pleasant Street Easthampton, MA 01027
#413-529-2428: shërbim: Massachusetts, Perëndimore

Advocates: Autism Alliance of MetroWest (AAMW)
(Aleancë e MetroWest për autizëm)
14 Central Street Natick, MA 01760
#508-652-9900: shërbim: Metropolitan perëndimor i Bostonit

Community Autism Resources (CAR)
(Burime të komunës për autizëm)
33 James Reynolds Rd, Unit C, Swansea, MA 02777
#508-379-0371: shërbim: Massachusetts, Juglindore

HMEA: Autism Resource Center
(Qendra burimore për autizëm)
71 Sterling Street, West Boylston, MA 01583
#508-835-4278: shërbim: Massachusetts, Qendrore

NEARC: The Autism Support Center
(Qendra e mbështetjes për autizëm)
6 Southside Road, Danvers, MA 01923
#978-777-9135: shërbim: Massachusetts,Verilindore

TILL, Inc.: Autism Support Center
(Qendra e mbështetjes për autizëm)
20 Eastbrook Road, Dedham, MA 02026
#781-302-4600 x 4661: shërbim: Boston

The Arc of South Norfolk: The Family Autism Center
(Qendra familjare për autizëm)
789 Clapboardtree Street, Westwood, MA 02090
#781-762-4001, X. 395: shërbim: Zona i qarkut Norfolk